

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Vidar Stensland si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarit të EULEX-it Rene van Veen dhe gjyqtares së EULEX-it Iva Niksic, me zyrtarin ligjor të EULEX-it Agron Kelmendi si procesmbajtës, kanë mbajtur shqyrtimin gjyqësor në lëndën penale P.nr. 148/2016 kundër:

G.G., emri i babait [...], emri i nënës [...], me mbiemër të vajzërisë [...], i lindur më [...], me banim në fshatin [...], komuna e [...], ku ai ka banim të përhershëm, i etnisë shqiptare, shtetas i Kosovës, baba i pesë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike; në paraburgim nga 22.08.2014 deri më 21.11.2014 dhe nga 21.11.2014 në arrest shtëpiak;

Me aktakuzën e datës 15.12.2014, G.G. është akuzuar për veprat penale të Vrasjes të kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore sipas nenit 180 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe Mbajtjes në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve sipas nenit 374 (1) të KPK-së. Me aktakuzën e ndryshuar të datës 01.04.2016, G.G. akuzohet për veprat penale të:

1. Vrasjes së rëndë, sipas nenit 179 (1.5) të Kodit Penal të Kosovës¹, (Pika 1);
2. Mbajtjes në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve, sipas nenit 374 (1) të KPK-së, (Pika 2)
3. Përdorimit të armëve apo instrumentit të rrezikshëm, sipas nenit 375 (1) të KPK-së, (Pika 3)

Seancat e shqyrtimit gjyqësor, të hapura për publikun, janë mbajtur më datat 4 prill, 11, 12, 16, 17, 18, 19, 26 maj dhe 1 qershor 2016. Seanca e mbajtur më datë 17 maj, kur janë marrë në pyetje dëshmitarët I.D., N.Sh. dhe N.M. ishte e mbyllur për publikun. Seanca e datës 18 maj, kur janë marrë në pyetje ekspertët A.B., A.V. dhe G.H. ishte e mbyllur për publikun. Të gjitha seancat janë mbajtur në praninë e të akuzuarit, avokatit të tij mbrojtës dhe prokurores

¹ Ligji Nr. 04/L 082, në tekstin e mëtejshëm KPK

publike të EULEX-it Lili Oprea Stelluta (e zëvendësuar nga Neeta Amin më datën 1 qershor). Avokati i palëve të dëmtuara Burhan Maxhuni ishte i pranishëm më datat 11, 16, 17, 18 maj (zëvendësuar nga Bekim Dugolli), më datat 19 dhe 26 maj (zëvendësuar nga Hatixhe Latifi). Më datën 1 qershor ishin të pranishëm pala e dëmtuar H.Sh. dhe avokati i saj Sokol Dobruna. Trupi gjykues pati një këshillim dhe votim më datën 2 qershor 2016.

Në pajtim me nenin 366 paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës² më datë 3 qershor 2016 në seancën publike dhe në praninë e prokurores së EULEX-it, palëve dhe përfaqësuesve të tyre siç janë shënuar në procesverbal.

Gjykata nxjerr si në vijim:

AKTGJYKIM:

I. Nën Pikën 1;

I akuzuari **G.G.** :

SHPALLET FAJTOR dhe DËNOHET

për veprën penale të **Vrasjes në shkelje të nenit 178 të KPK-së**, në këtë mënyrë Gjykata e ricalëson akuzën në Aktakuzë në **Vrasje të rëndë** në shkelje të nenit 179 (1.5) të KPK-së.

Sepse

Më datë 04.08.2014, rreth orës 18:50, në rrugën "Sheshi Adem Jashari", në Skenderaj, konkretisht në tarracën e kafiterisë "N Qosh", i pandehuri G.G. e privoi nga jeta R.Sh.. I pandehuri G.G. së bashku me Z.G. ishin duke dalë nga kafiteria dhe duke shkuar në drejtim të sheshit, ndërsa R.Sh. ishte i ulur së bashku me personat në vijim: Sh.K. , N.K., S.H. , E.J., A.R., B.M., E.L., në një tavolinë në tarracë, në anën e majtë të të pandehurit. Kur i pandehuri

² Ligji Nr. 04/L-123, në tekstin e mëtejshëm KPK

ishte në shkallët dalëse të kafiterisë “N Qosh”, ai papritmas dëgjoi fjalët “Selam Alejkym”. Ai u ndal dhe e ktheu kokën në të majtë në drejtim nga erdhën fjalët. I pandehuri pastaj e vërejti R.Sh. i cili e kishte ngritur lart dorën e tij të djathtë dhe G.G. e kuptoi se përshëndetja Selam Alejkym kishte ardhur nga ai. G.G. dhe R.Sh. kishin pasur një konflikt që kishte zgjatur një kohë të gjatë.

G. u ndal në shkallë për një moment të shkurtër dhe pastaj reagoi duke iu afruar R.Sh.t duke e pyetur atë “A i ke mbledhë pleqtë për me bo be se ku ke qenë më 19.10?!”. Pastaj ndodhi një zënkë në mes të G.G.t dhe R.Sh.t. G.G. e çoi dorën drejt brezit. R.Sh. filloi ta shtynte tavolinën me dorën e tij të majtë dhe e shau G.G.n. R.Sh. njëherësh filloi të ngritej nga karrigia, e shtyu tavolinën tutje me dorën e tij të majtë dhe e drejtoi dorën e tij të djathtë drejt pjesës së brezit në anën e tij të djathtë.

Në këtë situatë G.G. ishte në gjendje të tronditjes së fortë mendore dhe e nxori revolen e kalibrit 7.62 mm, M-57 – gjysmë automatike, me numër serik [...], prodhim jugosllav dhe shtiu katër herë në drejtim të viktimës, në pjesën e sipërme të shpatullës së djathtë, në pjesën e jashtme të anës së djathtë dhe pjesën e sipërme të shpatullës së majtë. Plagët i shkaktuan viktimës gjakderdhje masive të jashtme dhe të brendshme nga të shqyerit e mushkërive dhe mëlçisë, si pasojë e veprimit dinamik të predhave të shkrepur nga arma e zjarrit. Si pasojë e kësaj, viktimi ndërroi jetë rrugës për në Spitalin e Mitrovicës.

G.G. ka shtënë katër herë nga një distancë më e vogël se një metër drejtpërdrejtë në drejtim të R.Sh.t dhe e shtëna nuk ka rrezikuar jetën e ndonjë apo më shumë personave përveç se të R.Sh.t.

Gjatë kryerjes së veprës së mësipërme i pandehuri ishte mendërisht i aftë dhe ka vepruar me dashje direkte.

II. Nën Pikën 2;

I akuzuari **G.G.:**

SHPALLET FAJTOR dhe DËNOHET

Për veprën penale të **Mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve**, në shkelje të nenit 374, paragrafit 1, të KPK-së.

Sepse

Nga data 04.08.2014 deri më 22.08.2014 në Kosovë, G.G. ka mbajtur në posedim armën – revolen e kalibrit 7.62 mm, M-57 – gjysmë automatike, me numër serik [...], prodhim jugosllav, pa leje, në shkelje të ligjit të zbatueshëm në lidhje me armët e tilla.

Gjatë kryerjes së veprës së mësipërme i pandehuri ishte mendërisht i aftë dhe ka vepruar me dashje direkte.

III. Nën Pikën 3;

Në pajtim me nenin 363 paragrafin (1.3) të KPP-së, Gjykata

REFUZON

Akuzën e **Përdorimit të mjetit të rrezikshëm**; neni 375 paragrafi (1) i KPK-së,

Sepse:

Vepra penale e **Përdorimit të instrumentit të rrezikshëm** në këtë rast konsumohet nga kryerja e veprës penale e **Vrasjes**.

IV. PRANDAJ,

I akuzuari **G.G.**, në pajtim me dispozitat e neneve 178, 45, 75 paragrafin (1.2) dhe 76 të KPK-së, dënohet me 4 – katër – vjet burgim për veprën penale në fjalë nën Pikën 1.

I akuzuari **G.G.**, në pajtim me nenet 374 paragrafin (1), 45, 75 paragrafin (1.3) dhe 76 të KPK-së, dënohet me burgim prej 10 – dhjetë – muajve për veprën penale në fjalë nën Pikën 2.

Në pajtim me nenin 80 paragrafin (2.2) të KPK-së, Gjykata shqipton dënimin **UNIK** në vijim dhe;

Prandaj; i akuzuari **G.G.** do të kryej 4 – katër – vjet e 6 – gjashtë – muaj burgim.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 22.08.2014 deri më datën 21.11.2014 dhe koha që ai ka kaluar në arrest shtëpiak që nga data 21.11.2014 përfshihet në dënimin me burgim në pajtim me nenin 365 paragrafin (1), nën-paragrafin (1.5) të KPP-së

V. Konfiskimi

Revolja e përdorur nga G.G.; - revolja e kalibrit 7.62 mm, M-57 – gjysmë automatike, me numër serik [...], prodhim jugosllav, konfiskohet në pajtim me nenin me 374 të KPK-së, neni 374 paragrafin (3).

VI. Shpenzimet procedurale

I akuzuari G.G. duhet të paguajë **1000 (një mijë)** Euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale, por lirohet nga detyra për të kompensuar shpenzimet tjera në pajtim me nenin 453 paragrafët (1) dhe (4) të KPP-së. I akuzuari G.G. duhet të kompensojë shumën e urdhëruar jo më vonë se 30 ditë nga dita kur ky Aktgjykim të merr formën e prerë

VII. Kërkesat pasurore juridike

Në pajtim me nenin 463 të KPP-së, pala e dëmtuar H. Sh. udhëzohet se ajo mund të realizojë kërkesën e saj pasurore juridike në kontest civil.

Rene van Veen

Vidar Stensland

Iva Niksic

Gjyqtar i EULEX-it

Kryetar i trupit gjykues i EULEX-it

Gjyqtare e EULEX-it

Agron Kelmendi

Procesmbajtës

ARSYETIMI

Përmbledhje e çështjeve procedurale

Më 15 dhjetor 2014, prokurori vendor i Kosovës i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës ngriti aktakuzën e datës 15 dhjetor 2014 me numër PP. I. 208/2014 kundër G.G.t pranë Gjykatës Themelore të Mitrovicë.

Më 14 janar 2015, prokurori vendor i Kosovës i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës e mbajti dëgjimin fillestar.

Më 20 janar 2015, avokati mbrojtës paraqiti kërkesë për hedhjen poshtë të aktakuzës.

Më 12 shkurt 2015, i pandehuri dorëzoi një propozim lidhur me zbulimin e provave.

Më 13 shkurt 2015, Gjykata Themelore e Mitrovicës e mbajti seancën e dytë dëgjimore. Në të njëjtën datë, Gjykata Themelore e Mitrovicës e refuzoi kërkesën për ta hedhur poshtë aktakuzën e datës 20 janar 2015.

Më 13 maj 2015, Gjykata Themelore e Mitrovicës e mbajti seancën e parë të shqyrtimit gjyqësor. Pas asaj seance, kryetari i trupit gjykues dha dorëheqje.

Më 18 janar 2016, Kryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës ia caktoi lëndën EULEX-it në Gjykatën Themelore të Mitrovicës.

Më 4 prill 2016, Gjykata Themelore e Mitrovicës e EULEX-it filloi ta dëgjojë lëndën nga fillimi në shqyrtim gjyqësor. Janë mbajtur këto seanca të shqyrtimit gjyqësor më: 11, 12, 16, 17, 18, 19, 26 maj dhe 1 qershor 2016.

Pala e dëmtuar paraqiti kërkesë për kompensim.

Kompetenca e Gjykatës

Veprat penale që janë kryer në rajonin e Skenderajt bien nën juridiksionin lëndor dhe territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës sikurse parashihet me nenin 29, paragrafët (1) dhe (2) të KPP-së dhe nenin 9, paragrafi (2), nën-paragrafi (2.7) të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199).

Më 18 janar 2016, Kryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës lëshoi një Aktvendim G.J.A.nr.13/16 me të cilin emëroi gjyqtarin e EULEX-it Vidar Stensland si kryetar të trupit gjykues dhe gjyqtarët e EULEX-it Iva Niksic dhe Rene Van Veen si anëtarë të trupit gjykues në këtë lëndë. Emërimi bazohet në Ligjin nr. 03/L-53 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, në veçanti në nenin 2, paragrafi (2.2) dhe në Marrëveshjen ndërmjet Shefit të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18.06.2014, neni 5, pika a.

Rrjedhimisht, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it ka juridiksion mbi këtë lëndë.

Është fakt notor se që nga marsi i vitit 2008 deri në ditën kur është marrë aktgjykimi, për shkak të kërkesave specifike të sigurisë në veri të Mitrovicës, ka qenë një praktikë e themeluar mirë që lëndët penale në Gjykatën Themelore të Mitrovicës të gjykohen nga trupat gjykues të përbërë ekskluzivisht nga gjyqtarët të EULEX-it. Kjo praktikë kurrë nuk është kontestuar nga gjykatat e çfarëdo shkalle. Neni 6 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (GJEDN) si dhe neni 31, paragrafi 2, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh të drejtën për qasje në gjykatë jo vetëm për të pandehurit

por edhe për palët e dëmtuara. Nocioni i “tribunalit të themeluar me ligj” që përdoret në dispozitën e cekur të GJEDN-së po ashtu i referohet legjislacionit vendor mbi juridiksionin territorial dhe faktik. Duket sikur pjesëmarrja ekskluzive e gjyqtarëve të EULEX-it ishte mënyra e vetme për ta zbatuar të drejtën për qasje në gjykatë.

Provat e paraqitura

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë dëgjuar këta dëshmitarë:

A.R. më 04.04.2016,
Sh.K. më 11.05.2016,
B.M. më 11.05.2016,
H.G. më 12.05.2016,
E.L. më 12.05.2016,
V.B. më 12.05.2016,
S.G. më 16.05.2016,
B.N. më 16.05.2016,
Z.G. më 16.05.2016,
B.H. më 16.05.2016,
S.M. më 17.05.2016,
A.N. më 17.05.2016,
I.D. më 17.05.2016,
N.SH. më 17.05.2016,
N.M. më 17.05.2016,
H.Sh. më 01.06.2016.

Nuk ka qenë e mundur të thirren disa dëshmitarë dhe gjykata vendosi, pasi u pajtuan palët, që dëshmitë e tyre para prokurorit mund të lexoheshin në përputhje me nenin 338, paragrafi (1), nën-paragrafi (1.3). Kjo është bërë për deklaratat e këtyre dëshmitarëve; S.H., E.J. dhe H.B..

Këta dëshmitarë ekspertë janë marrë në pyetje më 18.05.2016:

A.B., psikiatër,
A.V., psikologe,
G.H.; neuro-psikiatër,
F.B., patolog i forenzikës.

I pandehuri G.G. zgjodhi që ta jep dëshminë më 19.05.2016. Atij po ashtu iu dha mundësia që ta jep një deklaratë shtesë pasi dëshmitarja H.Sh. dha deklaratë më 03.06.2016.

Gjykata lëshoi një aktvendim më datën 19 maj 2016³ duke vendosur rreth kërkesave për prova nga i pandehuri të datës 05.05.2016 dhe 16.05.2016. Në aktvendim, intervista me palën e dëmtuar H.Sh. nuk është pranuar si provë, ngase deri në atë moment gjykata nuk ka qenë në gjendje që ta thërras. Megjithatë, ajo u paraqit në seancën dëgjimore më datën 01.06.2016 dhe e dha dëshminë më 03.06.2016. Pastaj intervista e saj në procedurën paraprake është përdorur në përputhje me nenin 123 të KPP-së.

Kryetari i trupit gjykues lëshoi një aktvendim tjetër të datës 25 maj 2016 rreth kërkesës së prokurorit për t'i përfshirë si prova të gjitha dokumentet e listuara në indeksin e regjistratorëve I, II dhe III, pra e e tërë dosja e lëndës.

Dokumentet në vijim janë paraqitur nga prokurori të cilat Gjykata i ka pranuar si prova:

REGJISTRATORI I		
1. Raporti për shikimin e vendit të krimit – PK Sh.G.	04/08/2014 @ ora 21:57.	37-40
2. Memorandum i PK-së – Kërkesë për përgjimin e telekomunikimeve	05/08/2014	51-54
3. Memorandum i PK-së – Kërkesë për nxjerrjen e të gjitha thirrjeve ardhëse/shkuese	05/08/2014	55-59
4. Memorandum i PK-së – Kërkesë për marrjen e DVR nga restoranti Garden	06/08/2014	72-73
5. Memorandum i PK-së – Kërkesë për lëshimin e urdhrit për shqyrtimin e provave	06/08/2014	74-77
6. Memorandum i PK-së – Kërkesë për lëshimin e urdhrit për shqyrtimin e provave	07/08/2014	78-79
7. Memorandum i PK-së – Kërkesë për përgjimin e telekomunikimeve	14/08/2014	82-87
8. Memorandum i PK-së – Kërkesë për urdhërimin	14/08/2014	88-91

³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 19 maj 2016 faqe 2 dhe 3, versioni Anglisht. Të gjitha referimet tjera procesverbalit i bëhen versionit Anglisht.

e masave të fshehta të hetimeve		
9. Memorandum i PK-së – Kërkesë për përgjimin e telekomunikimeve	20/08/2014	92-95
10. Memorandum i PK-së – Kërkesë për urdhër	21/08/2014	96-97
11. Memorandum i PK-së – Kërkesë për urdhër	21/08/2014	98-99
12. Memorandum i PK-së – Kërkesë për ndërprerjen e përgjimeve	25/08/2014	100-103
13. Memorandum i PK-së – Kërkesë për revokimin e Urdhrit për Arrestim	25/08/2014	104-105
14. Memorandum i PK-së – Kërkesë për lëshimin e një urdhri për shqyrtimin e provave	30/08/2014	106-107
DOKUMENTET E PROKURORISË:		
15. Kërkesë për masa të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit	14/08/2014	174-177
16. Kërkesë për lëshimin e një urdhri për përgjimin e telekomunikimeve	18/08/2014	178-181
17. Kërkesë për lëshimin e një urdhri për përgjimin e telekomunikimeve	20/08/2014	182-185
18. Kërkesë për lëshimin e një urdhri për përgjimin e telekomunikimeve	21/08/2014	186-189
19. Kërkesë për ndërprerjen e urdhrit për masat e fshehta	21/08/2014	190-191
20. Vendim për ekspertizë daktiloskopike	25/08/2014	204-205
21. Vendim për ekspertizë balistike të armës	25/08/2014	206-207
22. Urdhri për kryerjen e përshkrimit dhe autopsisë së R.Sh.t		208-209
23. Vendim për ekspertizë balistike	09/09/2014	210-212
24. Shënim zyrtar nga PTH V.B.	24/10/2014	229-230
25. Shënim zyrtar nga PTH V.B.	29/10/2014	231-232
26. Procesverbali për rishqyrtimin e vendit të krimit	29/10/2014	233-234
27. Shënim zyrtar nga PTH V.B.	31/10/2014	237-242
28. Vendim për ekzaminim të telefonit	26/11/2014	258-261
29. Kërkesë për lëshimin e një urdhri për masa të fshehta	26/11/2014	262-265
30. Letër nga H.G.– përfaqësues i familjes G.	18/08/2014	282-285
31. Parashtrësë nga avokati mbrojtës Ndrece Dodaj	23/08/2014	286-289
32. Propozim për kryerjen e ekzaminimit psikiatrik nga DC	03/09/2014	304-307
33. Parashtrësë nga avokati mbrojtës Ndrece Dodaj	15/09/2014	308-313
34. Parashtrësë nga avokati mbrojtës Ndrece Dodaj	29/09/2014	334-337

REGJISTRATORI II		
DOKUMENTET E GJYKATËS:		
35. Urdhër për përgjimin e telekomunikimeve (IPKO)	07/08/2014	414-417
36. Urdhër për përgjimin e telekomunikimeve (VALA)	07/08/2014	418-421
37. Urdhër për regjistrimin e telefonatave	07/08/2014	422-425
38. Kërkesë për lëshimin e fletë-rreshtimit	12/08/2014	426-429
39. Urdhër për lëshimin e fletë-rreshtimit	12/08/2014	430-433
40. Urdhër për vëzhgim të fshehtë fotografik apo me video në vende publike, vende private dhe hetim të fshehtë	14/08/2014	434-439
41. Urdhër për përgjimin e telekomunikimeve	18/08/2014	440-443
42. Urdhër për përgjimin e telekomunikimeve	20/08/2014	446-449
43. Urdhër për përgjimin e telekomunikimeve	21/08/2014	450-453
44. Parashtrësë nga avokati mbrojtës Ndrece Dodaj	20/01/2015	665-674
45. Kërkesë nga avokati mbrojtës Ndrece Dodaj	16/02/2015	675-678
DËSHMITË		
Deklaratat e dëshmitarëve		
46. Procesverbal i ekzaminimit të dëshmitarit – E.J.	04/08/2014	691-697
47. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit – E.J.	03/10/2014	698-703
48. Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit – M.M.	04/08/2014	704-709
49. Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit – Sh.H.	04/08/2014	710-715
50. Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit – B.B.	04/08/2014	716-721
51. Procesverbal i ekzaminimit të dëshmitarit – Xh.T.	04/08/2014	722-728
52. Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit – V.B.	04/08/2014	729-732
53. Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit – V.B.	23/09/2014	733-738
54. Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit – E.L.	05/08/2014	739-745
55. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit – E.L.	03/10/2014	746-754
56. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit – S.H.	05/08/2014	755-761
57. Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit – A.R.	05/08/2014	762-767
58. Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit – N.K.	05/08/2014	768-774
59. Procesverbal i ekzaminimit të dëshmitarit – N.K.	15/09/2014	775-782
60. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit – Sh.K.	05/08/2014	783-789
61. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit – Sh.K.	10/10/2014	790-795
62. Procesverbal i ekzaminimit të dëshmitarit – B.M.	05/08/2014	796-799
63. Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit – B.M.	15/09/2014	800-805
64. Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit – A.R.	05/08/2014	806-808
65. Procesverbal i ekzaminimit të dëshmitarit – A.R.	15/09/2014	809-817

66. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit – H.G.	23/09/2014	818-827
67. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit – S.G.	10/10/2014	828-833
68. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit – H.B.	10/10/2014	834-839
69. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit – Z.G.	14/10/2014	840-846
70. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit – B.H.	14/10/2014	847-852
71. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit – N.SH.	23/10/2014	853-860
72. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit – I.D.	23/10/2014	861-866
73. Procesverbal i intervistimit të dëshmitarit – S.M.	23/10/2014	867-873
74. Procesverbal i ekazminimit të dëshmitarit – H.Sh.	10/11/2014	874-881
Deklarata e të pandehurit		
75. Procesverbal i intervistimit të të pandehurit – G.G.	22/10/2014	882-898
Regjistratori III		
Mjekët ligjor / Dëshmitarët ekspertë / Provat materiale		
76. Lista e provave/Zinxhiri i ruajtjes – pistoleta TT	05/08/2014	903-904
77. Raporti mbi ekspertizën – ekzaminimin e telefonave mobil	27/11/2014	907-914
78. Fotoalbum i telefonave të konfiskuar	27/11/2014	915-926
79. Lista e provave/Zinxhiri i ruajtjes –D7.1, D7.2	04/08/2014	927-928
80. Raporti i ekspertizës - provat D2, D3, D4 dhe D5	26/08/2014	929-934
81. Raporti i ekspertizës - pistoleta M-57	26/08/2014	935-942
82. Vendimi për ekspertizë balistike (<i>nuk është përkthyer</i>)	09/09/2014	943
83. Zinxhiri i ruajtjes Formulari B/ Lista e provave Formulari D	26/08/2014	944-945
84. Lista e armëve të sekuestruara	22/08/2014	946-947
85. Vërtetimi për kthimin e gjërave të sekuestruara	05/08/2014	948-949
86. Përmbajtja e dosjes forenzike		950-951
87. Foto album – Vrasje – PK Sh.G.	04/08/2014	952-970
88. Vërtetimi për konfiskimin e armës dhe municionit	04/08/2014	971-972
89. Procesverbal i bastisjes së personave apo banesës	04/08/2014	973-976
90. Përmbajtja e dosjes forenzike	06/08/2014	977-978
91. Raporti i vendit të krimit – Rreshter P.F.	05/08/2014	979-984
92. Foto album – Vrasje – PK B.O.	04/08/2014	985-1016
93. Foto album – Vrasje –Spitali Rajonal i Mitrovicës	04/08/2014	1017-1040
94. Skica pa përmasa e vend-krimit	04/08/2014	1041-1046

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P.nr. 148/2014

Mitrovicë, 3 qershor 2016

95. Raporti i autopsisë - MA 14-206 – R.Sh.		1047-1059
96. Raporti mjekësor – Konfirmimi i vdekjes	04/08/2014	1060-1061
97. Formulari forenzik për ekzaminim laboratorik	05/08/2014	1062-1063
98. Formulari i ekspertizës –Testi forenzik laboratorik (D)		1064
99. Legjenda – Matja	04/08/2014	1065-1068
100. Raporti i autopsisë – PK A.F.	05/08/2014	1069-1070
101. Raporti i autopsisë – PK S.A.	06/08/2014	1071-1074
102. Foto Albumi - MA 14-206	05/08/2014	1075-1090
103. Raporti plotësues, PK B.O.	29/10/2014	1091-1092
104. Foto Albumi – rishikimi i vendngjarjes	29/10/2014	1093-1099
105. Skica pa përmasa	29/10/2014	1100-1101
106. Raporti i policit – PK A.A.	11/01/2016	1102-1103
107. Lista e provave / Zinxhiri i ruajtjes - Ora e dorës	11/01/2016	1104-1107
108. Letra përcjellëse nga VALA – dy CD të bashkëngjitura	04/12/2014	1108
109. Letra përcjellëse nga VALA – dy CD të bashkëngjitur nga kamerat e restorantit Garden,		1109
110. Raporti mjekësor për G.G.n	18/11/2015	1110-1111
111. Raporti i ekzaminimit psikologjik për G.G.n	19/11/2014	1112-1131
112. Raporti mjekësor – vizita mjekësore shtëpiake – G.G.	22/07/2015	1132-1133
113. Raporti mjekësor – vizita mjekësore shtëpiake – G.G.	28/08/2015	1134-1135
114. Artikulli i gazetës “Bosta Sot” – Shoqata Kosovare e Gazetarëve e dënon kërcënimin ndaj kryeredaktorit I.M. dhe gazetarin N.SH.	01/08/2014	1136-1139

Në bazë të nenit 349, dosja penale e të pandehurit është prezantuar nga prokurori pas prezantimit të provave.

Dokumentet vijuese janë bashkëngjitur dhe prezantuar përmes kërkesës së parashtruar më 5 maj 2016 nga i pandehuri dhe të pranuar nga Gjykata si prova:

- Një artikulli botuar në gazetën ditore Koha Ditore më [...] (shih shtojcën nr.5);
- Përmbledhja e deklaratës nr.59 e Shtabit të UÇK-së e datës [...] (shtojca nr. 6);
- Përgjigja ndaj deklaratës nr. 59 të Shtabit të UÇK-së e datës [...] (shtojca nr. 7);

- Ftesa e PSRK në rastin PPS [...] e dërguar G.G.t. (shtojca nr. 9);
- Njoftimi nga PSRK në rastin PPS [...] i G.G.t (shtojca nr. 10);
- Letra e dëshmitarit A.N. (shtojca nr. 11);
- Kopja e SMS (shtojca nr. 13);
- Faqja e parë e aktakuzës në rastin PP. [...] e datës [...] të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës (shtojca nr. 14);
- Përmbledhja e aktgjykimit të Gjykatës Administrative të Shtutgartit, Gjermani, e datës [...] (shtojca nr. 15);
- Njoftimi nga G.G. për UNMIK-un dhe EULEX-in i datës [...] (shtojca nr. 16);
- Kopja e SMS (shtojca nr. 18);
- Artikulli i lajmit nga internetit (Insajderi) dhe CD-ja lidhur me Azem Sylën (shtojca nr. 19);
- Raporti mjekësor lidhur me G.G.n i datës [...] (shtojca nr. 21);

Dokumentet vijuese janë bashkëngjitur dhe prezantuar përmes kërkesë së parashtuar më 16 maj 2016 nga i pandehuri dhe janë pranuar nga Gjykata si prova :

- Leja për armë e G.G.t (shtojcat nr. 1 dhe 2);
- Raporti mjekësor i datës 05.05.2016 (shtojca nr.4);

Gjykata konstaton se ekziston një gabim shtypi në procesverbalin e datës 19.05.2016, faqe 2 në paragrafin e dispozitivit të aktvendimit ku shkruan “6??”. Kjo duhet të fshihet. Në procesverbal më tutje mund të vërehet se palët janë pajtuar me atë se një përmbledhje e shtojcës 6 mund të përdoret si provë.

Me kërkesën e të pandehurit Gjykata vendosi të mbledhë dhe të pranojë si prova dosjen penale të viktimës R.Sh..

Vlerësimi i provave

1. Incidenti në kafenenë “N’Qosh” më 04.08.2014
2. Gjykata konstatoi se faktet e përshkuara në dispozitiv të jenë dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Gjykata i ka bazuar konstatimet e saj në deklaratat e të pandehurit dhe të dëshmitarëve okular, të cilat kryesisht i përshkruan ngjarjet faktike të vrasjes në mënyrë të ngjashme, e cila gjithashtu përforcohet nga provat forenzike. Gjykata do t’i përsëritë disa pika themelore të asaj që është deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor.
3. **A.R.** ishte bashkë me R.Sh. kur ndodhi vrasja. Ai deklaroi⁴:

Pas një kohe, R. ishte para meje në anën time të majte ndërsa unë isha me shpine i kthyer kah hyrja e lokalit dhe e pash R. n që e ngriti dorën e djathtë dhe tha “Selam Alejkum”. Unë shikova kah ana ime e djathtë dhe po shikoja se kënd e përshëndeti ai dhe e pashe se G.G. po dilte jashtë lokalit i cili doli jashtë lokalit dhe tashme ishte në shesh e pastaj ai erdhi në drejtimin tonë, u kthye kah në dhe iu drejtuar R.Sh.t me këto fjale: “A të kam thënë ti mbledhësh pleqtë dhe të betohesh se ku ke qenë me datën 19 tetor?” dhe R.Sh. i tha “Ec udhës tënde” dhe e ngriti dorën, duke treguar që ...

Kryetari i trupit gjykues: Dorën e djathtë apo të majtën?

A.R. : Dorën e djathtë. G. ju afrua atij gati një metër dhe ai e vendosi dorën e tij të djathtë në bel.

Kryetari i trupit gjykues: Ai G., apo?

A.R. : G., dhe R.Sh. iu drejtua atij me këto fjale: “pse pe qet duart në bel? Nxjerre dhe gjuaj, askush nuk po frikohet nga ti”. Dhe G. e nxori armen; e përgatiti, e mbushi dhe e qëilloi R.Sh. katër herë. Ai iku nga lokalet me armë në dore në drejtim të panjohur. Në u munduam ti japim ndihme pasi që ai ende ishte gjalle. Ermali me një tjetër person dolën jashtë dhe e ndalen një veture dhe B., N. dhe E. dhe njerëzit e tjerë ndihmuan ta fusim atë në veture dhe e dërguan në Qendrën e Shëndetit në Skënderaj.

⁴ Procesverbal shqyrtimi gjyqësor 04.04.2016 faqe 10 dhe 11

4. Më tutje ai deklaroi⁵:

Iva Niksic: Nëse te kujtohet ne çfarë pozicioni ishte R.Sh.? A ka qene ai ulur, duke qëndruar ne këmbë apo duke u ngritur kur i pandehuri po përgatitej të qëllonte?

A.R. : Ai ka qene ne pozicionin ulur.

Iva Niksic: Dhe kur I pandehuri po e qëllonte atë në cilin pozicion ishte ai?

A.R. : Ulur.

Rene Van Veen: Para se G.G. ta qëllonte atë a e ka lëvizur dorën e vet R. ?

A.R. : Jo.

Kryetari i trupit gjykues: A e ke parë atë duke bërë ndonjë gjë me duar?

A.R. : Kur ai i vendosi duart në bel ky i tha nxjerre dhe qëllo. Dhe pastaj ai e bëri këtë.

5. **Shani Koca**, i cili ishte në tavolinë me R.Sh., deklaroi⁶:

Pra, në këtë kohë derisa isha duke e përshëndetur dhe duke thënë “Tungjatjeta” këtij E., pastaj në ndërkohë e dëgjova një fjalë që e tha R. që ishte “Selamualejkum” dhe u ktheva për të parë kujt po i drejtohej në atë mënyrë dhe pastaj e vërejta se aty ishte G.G.. Pra e dëgjova G.G.n duke e pyetur atë, “a ia dole t’i mbledhësh 24 pleq që të vijjnë dhe të tregojnë nën betim se ku ishe më datën 19” dhe pastaj ai e vendosi dorën në bel për ta marrë revolen, unë faktikisht nuk e pashë nëse kishte revole apo jo por e di se e vuri dorën në bel. Nuk e pashë revolen derisa nuk e nxori.

6. **B.M.** ishte gjithashtu bashkë me R.Sh.. Ai deklaroi⁷:

Isha ulur me shpinë i kthyer kah dera e kafenesë derisa ai na kaloi, ai pastaj e kaloi R. n i cili ishte ulur në pozicionin si ky polici që ishte ulur pranë meje dhe e dëgjova duke thënë “Selamalejkum” dhe e pyeta nëse i kishte mbledhur pleqtë për takim, për cilin

⁵ Procesverbal i shqyrtimi gjyqësor 04.04.2016 faqe 14

⁶ Procesverbal i shqyrtimi gjyqësor 11.05.2016 faqe 3

⁷ Procesverbal i shqyrtimi gjyqësor 11.05.2016 faqe 12

takim nuk më kujtohet për momentin. Pastaj ai tha “vetëm shko”, duke e përdorur një fjalë e cila nuk është e hijshme të përdoret në këtë çast “nxirre dhe gjuaj sepse nuk më plas fare” pastaj G. e nxori arën dhe gjuajti. Kaq.

it.

7. **E.L.**, gjithashtu në grup bashkë me Sh., deklaroi⁸:

Derisa isha duke folur me Sh., nuk zgjati më shumë se 10 deri në 15 minuta, G. doli përjashta kafenesë dhe kaloi pranë nesh. Ai nuk na njohu, nuk e di nëse na vërejti apo jo por nuk e ktheu kokën kah ne. Prandaj, ai kaloi pranë nesh dhe R. e ngriti dorën duke thënë Selam Alejkum sa më kujtohet. G. u ndal, u kthye dhe u ndal te shkallet dhe i tha atij “A i mblodhe njerëzit për ta dhënë besën” dhe R. e përshëndeti me Selam Alejkum dhe kur G. nga largësia e pyeti nëse i kishte mbledhur njerëzit për besën, R. nuk u përgjigj në atë pyetje dhe G. na u afrua neve. Kur erdhi afër nesh ishte zbehur në fytyrë dhe ai përsëri iu drejtua atij duke thënë “A i mblodhe njerëzit për ta dhënë besën” dhe nuk më kujtohet cilën datë e përmendi. Dhe ai tha, “Do të shihemi”, dhe G. përsëri tha, “duhet t’i mbledhësh njerëzit shumë shpejt”. R. pastaj disi lëvizi pak në karrige dhe nuk e di nëse këtë e bëri me qëllim apo jo, dhe G. e vuri dorën e tij në revole. Unë intervenova në atë çaste dhe u ngrita në këmbë, dhe u thashë t’i linin këto gjëra sepse po silleshin si fëmijë dhe pastaj G. e largoi dorën nga revolja. Pastaj R. u përgjigj, “A po provon të më frikësosh?” dhe tha “ta pshurri në të” dhe gjithashtu e përmendi një fjalë tjetër të cilën nuk e di nëse mund ta përmend.

Kryetari i trupit gjykues: Po.

E.L.: Është në deklaratën time që e dhashë në polici dhe të prokurori.

Kryetari i trupit gjykues: Na duhet ta dimë çfarë ka thënë me saktësi.

E.L.: Disi e kam turp ta them. Ai tha “të pshurrsha në të, shko në kar” dhe një tjetër fjalë, se a e ka sha a jo nuk më kujtohet dhe për mënyrën si ishte ulur R. në karrige ai

⁸ Procesverbal i shqyrtimi gjyqësor 12.05.2016 faqe 12 dhe 13

së pari po i mbante duart e tij në tavolinë dhe kishte veshur këmbë dhe kravate dhe i vuri duart poshtë (duke treguar dorën e djathtë në prehrin e djathtë), pra R. ishte ulur nga ana ime e djathtë, dhe pastaj kur e lëshoi dorën në prehër G. reagoi. Kur R. i largoi duart nga tavolina dy a tri shishe u rrëzuan, nuk di a një a dy, dhe pastaj pistoletë shkrep. Nuk di se kush e ka dërguar në spital, nuk më kujtohet aspak.

8. **V.B.** ishte duke punuar në kafenenë “N’Qosh” më 04.08.2014, por ai u largua para se të ndodhnin të shtënat.

9. **S.G.** ishte në shkallët e kafenesë “N’Qosh” kur ndodhën të shtënat. Ai deklaroi⁹:

Ditën që ndodhi isha duke hyr në kafene apo lokal me kushëririn tim, ishim duke hyrë në lokal dikur ndodhi. Andaj, nuk dëgjuam asgjë sepse kishte zhurmë dhe muzika ishte e zëshme. Pra kur ndodhi G. ishte te tavolina anash na unë, dhe më kujtohet kur R. u ngrit nga tavolina dhe e vuri dorën në revole dhe pasta ngjarja ose rasti ndodhi. [...]

I thash kushëririn tim, “Ruaju” sepse R. ishte duke nxjerrë revolen, dhe nuk e pashë G.n sepse ai është në anën tjetër nga unë. (...)

Kryetari i trupit gjykues: Pyetja ime ishte kur G.G. ishte duke gjuajtur, a e kishte R. atëherë revolen në dorë apo e kishte ende në bel?

S.G. : Vetëm e pashë kur e nxori revolen dhe pastaj gjithçka filloi, zhurma dhe të shtënat, kjo është e gjitha që mund të mbaj në mend dhe ai ra në dysheme.

10. **Z.G.** i cili u largua nga kafeneja me G.G.n, deklaroi¹⁰:

Pra, derisa ishim duke dalë përjashta ishte një fjalë arabe e cila na tërhoqi vëmendjen dhe kjo ishte Selam Alejkum dhe erdhi nga një tavolinë e cila ishte në anën tonë të majtë. E dëgjova këtë shprehje dhe e ktheva kokën por mendova se erdhi nga shoku i G.t dhe nuk e mora si tragjike pasi që mendova se ishte shoku i G.t dhe vazhdova. Në

⁹ Procesverbal i shqyrtimi gjyqësor 16.05.2016 faqe 5, 6 dhe 10

¹⁰ Procesverbal i shqyrtimi gjyqësor 16.05.2016 faqe 19 dhe 20

atë çast isha duke e shikuar G.n i cili nguronte të shkonte, pra një herë nguroi të dilte nga kafeneja apo nga tarraca dhe në fund shkoi te ajo tavolina. Kur u kthye dhe shkoi te tavolina unë vetëm u ktheva dhe nga shkallët e pashë çka ndodhi dhe ata ishin duke e pasur njëfarë dialogu mes tyre. Në atë çast R. i ndjerë ose R.B., pasi që nuk e di emrin e tij të plotë, e pashë duke e vënë dorën e tij të majtë mbi tavolinë duke e shtyrë trupin e tij përprjetë dhe me dorën e tij të djathtë ai ishte disi duke u ngritur por nuk u ngrit por duke se ishte ngritur por gotat dridheshin Dhe e tërë kjo skenë zgjati rreth 20-30 sekonda dhe pastaj ndodhi rasti. Në atë çast kur ishin duke biseduar nuk i dëgjova çka i thoshin njëri-tjetrit sepse në kafene kishte muzikë dhe kishte zhurmë dhe nuk mund t'i dëgjoja çka thoshin.

11. Ai përmendi se G. gjuajti 3 apo 4 herë dhe nuk e pa kurrfarë revole në dorën e R. t. Atij gjithashtu iu kujtua se kishte persona të tjerë aty në shkallë dhe njëri nga ata madje ia shkeli këmbën, e cila gjë vërtetohet me deklaratën e H.B. dhe Z.G.t.

12. **B.H.** deklaroi¹¹ se ai ishte në kafenenë "Holivud" afër lokalit "N'Qosh" ku e takoi R.Sh. pak kohë para vrasjes:

(R.) më pyeti se si je Bajram, si po e kalon me këta njerëz, a ke ndonjë problem me këta njerëz, nëse ke ndonjë problem unë do ta zgjidhi për ty sepse jam duke kërkuar probleme sepse kam dalë jashtë që të ia qi Nonën dikujt. Unë i thash se jo. Nuk kam problem me askënd ulu dhe merre një kafe. Ai tha, "Jo" disa shokë më kanë ftuar për kafe. Unë e përshëndeta atë me dorë dhe ai shkojë. Nuk kam shikuar më tej, pas disa minutash u dëgjua një zhurmë dhe i kam parë të ngritur dhe ndodhën të shtënat. Kur u dëgjuan zhurmat këta njerëz që ishin atje ishin ngritur në këmbë dhe kjo ishte ajo që unë kam parë.

¹¹ Procesverbal i shqyrtimi gjyqësor 16.05.2016 faqe 24

13. Palët u pajtuan se dëshmitë që iu dhanë prokurorit para avokatit mbrojtës nga **E.J. dhe H.B.**, të cilët nuk kanë mundur të ftohen dhe nuk erdhën në shqyrtim, janë lexuar.
14. **E.J.** më 03.10.2014 i deklaroi prokurorit se ai ishte në tavolinë me R. n. Ai e pa G.G.n duke dalë përjashta, por pastaj u kthye dhe u ballafaqua me R. n në largësi prej afër 1 metër. Dëshmitari e kishte vërejtur se G. kishte thënë diçka derisa ia kishte drejtuar gishtin R. t. R. , serioz, u kthyer për t'u ballafaquar me G.n dhe tha diçka. Dëshmitari tha se nuk e dëgjoi çka tha, shkak i problemeve me dëgjim. Ai tha se R. ishte në pozitë të ulur kur G. qëllloi me revole dhe ai nuk e kishte vërejtur nëse R. kishte revole fare.
15. **H.B.** e dha deklaratën e tij para prokurorit më 10.10.2014. Ai deklaroi se ishte duke ecur në drejtim të hyrjes së kafenesë "N'Qosh" bashkë me S.G. n. Ai pa se diçka po ngjante në një tavolinë në tarracën e kafenesë por nuk mund të dëgjonte se çka flitej apo thuhej. E gjitha ndodhi shumë shpejt, sa hap e mbyll sytë. Ai deklaroi, "Para se ti dëgjoja të shtënat, e vërejta se personi-viktima ishte gjysmë i ngritur në këmbë dhe dorën e majtë e kishte mbi tavolinë, ndërsa dorën e djathtë e kishte në bel, por nuk mund të them nëse ishte ajo revole në belin e viktimës, sepse incidenti ndodhi shumë shpejt, dhe në atë çast kur a pashë viktimën duke mbajtur dorën në bel menjëherë e dëgjova të shtënën(...)"
16. **S.H.** ai vetëm u intervistua nga policia dhe deklarata e tij nuk mund të përdoret si provë e drejtpërdrejt, shih nenin 123 i KPP.
17. **G.G.** vendosi të jep deklaratë më 19.05.2016, dhe Gjykata do t'i referohet disa pjesëve të deklaratës së tij:
Zijadini ishte duke ecur para meje, rreth dy deri tre hapa para meje dhe kamerierët na thanë se dikush i kishte paguar pijet tona. (...) Pastaj kalova pranë një tarrace të vogël, dhe gjithashtu kalova pranë një tarrace të dytë dhe duke zbritur shkallëve në

drejtim të sheshit e dëgjova një fjale arabe “Selamualejkum”. U ktheva majtas; kur u ktheva majtas i pashë disa persona të ulur rreth tavolinës dhe mes tyre ishte R.Sh.. E vërejtta ta ketë ngritur dorën duke më përshëndetur me “Selamualejkum”. Kur e pashë R. n u frikova, sepse kurrë më parë s’e kisha parë R. n në Skenderaj dhe edhe më pak në atë lokacion. Ai lokacion frekuentohej nga unë natën dhe ditën, dhe pasi që e kishim një takim i cili ishte iniciuar nga R. dhe jo nga unë, sepse ai më thirri me telefon të N.Sh. 5 – 6 ditë më parë, që është e shkruar në deklaratën time, dhe nëse më pyetni për këtë, mund t’ju përgjigjem. Pastaj u afrova te tavolina e tyre pa i vërejtur apo parë të tjerët përreth tij. I thashë, “ai ke mbledhur pleqtë për të bërë be ku ke qenë më 19 tetor” dhe R. e shtyu tavolinën.

Ai nuk më lejoi ta përmend vitin 2001, dhe me dorën e majtë ai po e shtynte tavolinën përpara. Në atë çast unë isha përpara R. t ndërsa të tjerët u shtynë prapa nga pozita e tyre, dhe ai më tha “hup” dhe më shau.

Ai u mundua të ngrihej dhe mua mu duk sikur me dorën e tij të djathtë ai deshi të merrte diçka të zezë dhe atë moment unë humba dhe për atë arsye nxora armën time dhe shtiva në drejtim të tij. Pastaj unë shkova drejt lokaleve tona që janë rreth 20 metra larg nga aty dhe pastaj shkova në shtëpi. Pasi që shkova në shtëpi unë vërejtta se arma ishte hapur dhe këmbëzën e sigurinë e kishte të çkyçur dhe me këtë unë kam mundur të lëndoja veten. Kjo ishte se çfarë kishte ndodhur në atë moment. Më shumë nuk më kujtohet.

[...]

Sipas dëshmitarit, ai tha; “vetëm më qëlllo”. A ju kujtohet ndonjë gjë prej kësaj? I referohem R. t i cili tha, “më qëlllo”.

G.G.: Ndoshta dëshmitarët ma kanë përkujtuar atë por nuk e di saktësisht si, nëse ai ka thënë “Pshurri në to” apo diçka të tillë dhe “ta qi nonën”, por e di se kur gotat ranë poshtë, pas këtyre fjalëve gotat ranë poshtë dhe ai e ngriti dorën dhe pas këtij momenti unë e nxora armën time dhe qëlllova.

18. G. tha se fyerja ishte ofendim i rëndë. Pastaj kryetari i trupit gjykues e pyeti nëse ishte e mundur që ai ta parashikonte ofendimin dhe G. u përgjigj:

Kur ai e shtyu tavolinën dhe e çoi dorën te brezi, pas kësaj erdhën disa reagime dhe pas fyerjes së nënës time unë nuk e dija se çfarë do të nxirrte ai, shkrepës apo thikë apo diçka tjetër. Ka qenë e pamundur për mua që të përcaktojë. Unë vetëm e perceptova si rrezik për mua dhe reagova.

Gjatë kohës që unë isha nën arrest shtëpiak në TV pash se një polic Amerikan e kishte vrarë një fëmijë duke menduar se fëmija kishte armë në dorë. Kur gjykata e liroi atë, i tërë qyteti Fergusson ishte në flakë. Kishte shumë protesta.

Kryetari i trupit gjykues: Ju thatë se nuk e dinit nëse ishte armë apo shkrepës apo thikë?

G.G.: Unë nuk isha vetvetja më.

Kryetari i trupit gjykues: A ju kujtohet nëse menduat se ajo mund të ishte armë, thikë apo çfarëdo?

G.G.: R.Sh. dihej se nuk do të mbante asgjë tjetër përveç armës. Mund ta pyesni këdo në Drenicë, të gjithë do të ju tregojnë se ai mbante armë.

Kryetari i trupit gjykues: A ju kujtohet, a keni pasur ndonjë mendim në atë moment nëse ai ka pasur armë ose jo?

G.G.: Mua më është dukur diçka si e zezë, si armë dhe unë mendova se ai do të më vret, dhe mendova që sa më shpejt që është e mundur ta nxjerri armën time.

19. Gjykata konstatoi se të gjithë dëshmitarët okularë deklaruan sinqerisht atë që e mbanin mend nga incidenti, dhe deklaratat në parim e vërtetuan njëra tjetrën. Ekzistojnë vetëm mospërputhje të vogla në mes të deklaratave, të cilat mund t'i atribuohen aftësisë së dëshmitarëve të ndryshëm për të vëzhguar, për të mbajtur mend, për të rikujtuar dhe përfundimisht për ta përshkruar me gojë incidentin në gjykatë.

20. Është vërtetuar se kur i pandehuri ishte te shkallët e daljes nga ambienti i kafenesë "N Qosh", ai i dëgjoji fjalët "Selam Alejkym". Ai u ndal dhe e ktheu kokën në të majtë nga ku u dëgjuan fjalët. I pandehuri pastaj e vërejti R.Sh. i cili e kishte ngritur dorën e tij të djathtë lartë dhe G.G. e kuptoi se përshëndetja Selam Alejkym erdhi nga ai. G.

ndaloi në shkallë për pak çaste dhe më pas reagoi duke iu afruar R.Sh.t duke e pyetur “A i mbloodhe pleqtë për t’u betuar se ku ishe më 19.10?!”. Atëherë u bë një fjalosje në mes të G.G.t dhe R.Sh.t.

21. Gjykata konstaton se citimi i E.L.fit për fjalët (fjalosjen) e thëna nga G. dhe R., siç cekët më lartë, si më i saktë dhe i vërtetuar. Në parim citimi është vërtetuar nga deklaratat tjera. Më tej, L. ishte i vetmi i cili u mundua të ndërhyjë dhe ta zvogëloj konfliktin, gjë që e bënë atë më shumë të vëmendshëm për atë që u tha në të vërtetë. Gjykata konstaton si të vërtetuar se G.G. e lëvizi dorën e tij te brezi. Më tej R.Sh. filloi ta shtyjë tavolinën me dorën e tij të majtë dhe e shau, siç u deklarua nga E.L., G.G.n, dhe R.Sh. në të njëjtën kohë filloi të ngritët nga karrigeje e tij, e shtyu tavolinën tutje me dorën e tij dhe e drejtoi dorën e tij të djathtë kah prehri në anën e tij të djathtë. Gjykata nuk e konstaton të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se G. në fakt ia ka treguar armën R. t. Megjithatë, duke e lëvizur dorën kah prehri i tij, R. e mori këtë lëvizje si shenjë që G. kishte armë. Fjalët e R. t: “nxirre dhe shtijë” e vërteton këtë. E.L. deklaroi se “*e vendosi dorën e tij në pistoletë*”. Gjykata nuk e gjen këtë si të mjaftueshme për të vërtetuar se G. ia ka treguar armën R. t. Fakti që G. në realitet menjëherë e nxori armën dhe shtiu, me gjasë e nxiti memorien e L..

22. Gjykata e gjen të vërtetuar se G.G. nuk ndodhej në një situatë të mbrojtjes së nevojshme, kur shtiu në R.Sh.. S.G. është i vetmi dëshmitari i cila ka deklaruar se e ka parë R.Sh. që kishte armë. Dëshmitarët e tjerë kanë deklaruar se nuk e kanë parë që R. kishte ndonjë armë. Informacioni i S.G. t nuk mbështetet nga asnjë nga dëshmitarët e tjerë okularë. Dhe as nuk është mbështetur nga ekzaminimi i vendit të krimit. Kur R. është sjellë në spital, asnjë armë dhe as këllëf arme nuk është gjetur. Natyrisht është e mundur që nëse R. kishte armë, që dikush ta ketë larguar apo fshehur nga policia. Megjithatë, nuk ka prova për ta mbështetur këtë teori. Madje as G.G. nuk ka deklaruar se e pa një armë, vetëm se ishte i frikësuar se R. ishte gati ta nxirrte armën. G.G. ka treguar në shqyrtim gjyqësor se B.Sh. ishte arrestuar 30 minuta pas incidentit dhe që ai e kishte një armë e cila ka mundur të jetë arma e R. t.

Është vlerësim i gjykatës se kjo është një teori e thjeshtë e cila nuk mbështetet me asnjë provë. Asnjëri nga dëshmitarët nuk e ka vendosur B.Sh. te vendi i krimit dhe nuk ka asnjë provë tjetër që tregon se B.Sh. ishte te vendi i krimit dhe ta ketë marrë në posedim armën e mundshme të R. t. Çanta e R. t bashkë me dokumente dhe të holla, kishte mbetur në tavolinë. Kjo tregon se pas të shtënave, shqetësimi kryesor i personave në vendin e krimit ishte që ta dërgonin R. n në spital sa më shpejt që të jetë e mundur. Gjykata duhet të vërtetojë se R.Sh. nuk bartte armë kur ndodhën të shtënat. Gjykata është e mendimit se S.G. deklaroi atë që mendoi se e kishte parë, por ai ishte gabim rreth fakteve.

23. Më tej, gjykata e gjen si të vërtetuar se R.Sh. rreth dy javë para 04.08.2014 ka pasur një operacion në lidhje me palcën kurrizore. A është liruar nga spitali rreth një javë para incidentit dhe më 04.08.2014, ai ende kishte dhimbje shpine dhe ishte e vështirë për të, të ulej normalisht dhe të lëvizte¹². Gjendja e tij e bëri edhe me më pak gjasa që ai donte ta sulmonte G.G.n.

24. Gjykata e gjeti si të vërtetuar se G.G. nuk besonte se ai ishte nën një sulm vdekjeprurës. Në shqyrtim gjyqësor ai së pari ka deklaruar se *“nuk e dinte se çfarë do të nxirrte ai, shkrepës apo thikë apo çfarë”,* pastaj pas marrjes në pyetje ai ka deklaruar: *“mua më është dukur diçka si e zezë, si armë dhe unë mendova se ai do të më vret, dhe mendova që sa më shpejt që është e mundur ta nxjerri armën time.”* Deklarata e tij se ai ka menduar që ishte armë është sipas mendimit të gjykatës një racionalizim i veprimit të tij të ndërmarrë pasi ai pati mundësinë që të reflektojë në atë se çfarë kishte bërë. Kjo është edhe më shumë pasi që asnjë dëshmitar përveç S.G.t nuk e ka vërtetuar se e ka parë R.Sh. duke bartur armë. Në vijim, kur merret parasysh marrëdhënia e keqe që në mes të G.t dhe R. t, që nga viti 1998, frika e G.t nga vrasja ndër vite, personalitetin e G.t dhe fyerjen e rëndë të R. t pak para të

¹² Deklarata e H.Sh.t e datës 01.06.2016. Është vërtetuar gjithashtu se R.Sh. ishte në spital edhe nga G.G. dhe S.M.

shtënave, kjo u bë edhe më e dukshme. Gjykata do ta shtjellojë këtë më poshtë më në detaje.

25. Gjykata e gjeti si të vërtetuar, në bazë të deklaratave të dëshmitarëve okular dhe G.G.t se G. po qëndronte rreth 1 metër larg nga R.Sh. pak para se G. të shtinte me armë. R. ishte gati të ngrihej në këmbë dhe ishte në pozitë gjysmë ulur kur është shtënë në të. Kjo është vërtetuar nga dëshmitarët okular dhe trajektores së plagëve të përshkuara në raport të autopsisë dhe me deklaratën e ekspertit Dr. F.B., në shqyrtim gjyqësor.

26. Gjykata e gjeti të vërtetuar se G.G. ishte në gjendje të rëndë shqetësimi mendor kur e ka vrarë R.Sh.. Kjo është e bazuar në raportin psikiatrik dhe deklaratave në shqyrtim gjyqësor nga psikiatri A.B., psikologja A.V.dhe neuropsikiatri G.H..

27. Ekspertët psikiatrik e përfunduan raportin e tyre si në vijim:

1. [...].

2. [...].

3. [...]

4. *Në momentin që ai e pa të ndjerin, në mendjen e tij u shfaq një emocion i fuqishëm i frikës, për të shpëtuar apo për të goditur, një situatë në të cilën një person po përballët me një gjendje delikate të jetës së tij. Në një gjendje të tillë ai nuk ka mundur ta kontrollojë, t'i frenojë veprimet e tij të cilat rezultuan me kryerjen e veprës penale.*

28. Gjykata nuk gjen veçanërisht baza për ta vënë në dyshim konkluzionin e tyre. Informacionet në raport në lidhje me historikun e G.G.t, janë vërtetuar mjaft shumë me prova të paraqitura nga G. dhe dëshmitarët të cilët kanë dhënë deklarata rreth historikut të lëndës. Dr. B. ka thënë në shqyrtim gjyqësor se të dhënat anamnesticke

ishin vetëm nga vetë G.G. (të dhëna auto anamnestike) siç ishte shkruar në raport.

Tendenca e reagimit të rrëmbyeshëm është shprehur qartë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Historiku

29. Gjykata konstatoi se ka pasur një konflikt të gjatë në mes të G.G.t dhe R.Sh.t dhe personave tjerë, me të cilët sipas mendimit të G. t, ishte i lidhur Sh.. G.G. ishte bindur më tej se që nga viti 1998 deri në gusht 2014, ishte në rrezik të lartë për t'u vrrarë nga R.Sh. apo nga persona të afërt me Sh..

30. Provat e paraqitura nga G. dhe deklaratat gjatë shqyrtimit gjyqësor nga dëshmitarët H.G.¹³, B.N.¹⁴, S.M.¹⁵, A.N.¹⁶, I.D.¹⁷, N.SH.¹⁸ dhe N.M.¹⁹, dhe tentim vrasja e G.G.t në vitin [...], japin indikacione se G.G. kishte arsye për t'u frikësuar se jeta e tij ishte në rrezik. Nuk i takon gjykatës që të vendos nëse kjo ishte e vërtetë dhe aq më pak të ketë një mendim rreth asaj se kush mund të jetë prapa këtij kërcënimi. Megjithatë, gjykata gjeti të vërtetuar se vetë G.G. ishte i bindur se ai për shumë vite ka qenë në një situatë kërcënuese për jetën dhe që R.Sh. bënte pjesë në këtë.

31. Gjykata nuk e sheh të nevojshme për qëllim të këtij gjykimi të kalojë në detaje rreth historikut siç është paraqitur nga dëshmitarët, G.G. dhe dokumentet e paraqitura nga G. . Megjithatë, gjykata shkurtimisht do të theksojë disa pjesë të mëdha.

32. G.G. ka deklaruar para psikiatërve²⁰ se konflikti me R.Sh. ka filluar në vitin 1998 kur R., sipas G. t, ia drejtoi armën G. t dhe e kërcënoi. Më [...], është bërë një tentim vrasje ndaj G.G.t. G.G. është plagosur ndërsa dy persona tjerë janë vrrarë. Nuk është

¹³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 12.05.2016

¹⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 16.05.2016

¹⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 17.05.2016

¹⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 17.05.2016

¹⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 17.05.2016

¹⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 17.05.2016

¹⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 17.05.2016

²⁰ Në shqyrtim gjyqësor G. vërtetoi se informacioni që ia kishte dhënë psikiatrit mund të konsiderohet si pjesë e deklaratës së tij, procesverbali i datës 18 maj, faqe 3

kontestuese se ka ndodhur tentim vrasja. G.G. ishte dhe është i bindur se Sh. ishte i përfshirë në tentim vrasjen në vitin [...].

33. Dëshmitari **A.N.**, ka deklaruar se ai ishte në burg në vitin 2000 me R.Sh., pastaj duke e përdorur emrin I.T. N. ishte dëshmitar i një episodi kur G.G. u shfaq në TV dhe reagimin e R. kur e pa G.n. Nuraj nuk e njohte personalisht G. n por pasi ka dëgjuar për incidentin më 04.08.2016, ai i shkroi një letër²¹ G.G.t duke e informuar rreth episodit në burg, dhe që ai ishte i bindur se G. “do të vritej nga R. në momentin e parë të përshtatshëm”. Gjykata nuk ka asnjë arsye për të mos besuar se informacioni në lidhje me episodin në burg është pjesë e historikut, megjithatë, gjykata nuk do t’i jep shumë vlerë provuese me që N. e dërgoi letrën vetëm pas 04.08.2016.

34. Dëshmitari **B.N.** deklaroi se rreth një muaj para 04.08.2014, ai e takoi R.Sh. dhe që R. i kishte thënë atij mos të “rrijë” me G. n. B.N. e informoi G.G.n rreth kësaj por që nuk e kishte takuar G.n pas kësaj pasi që R. ishte një shok i afërt dhe gjithashtu “ndoshta isha pak i frikësuar”.

35. Më [...], shtypi ditor Bota Sot botoi një artikull në lidhje me të gjitha vrasjet e pretenduara të anëtarëve të LDK-së për motive politike. R.Sh. u takua me gazetarin N..Sh. dhe përmes telefonit të N., R. e thirri G.G.. Sipas G.t²², R. e akuzoi G. n për dhënien e informacionit gazetës. Ata pastaj janë takuar dhe në këtë rast G. donte që R. të betohet se ai nuk ishte i përfshirë në tentim vrasjen në vitin [...]. Dëshmitari S.M. ishte i pranishëm gjatë këtij takimi.

36. S.M. deklaroi:

Rrugës tonë për në Prishtinë, G. dhe R. diskutonin në telefon për vendin se ku do të takoheshin. Më kujtohet që ai t’i ketë thënë atij se do të takoheshin te “A. M.” edhe

²¹ Bashkëngjitja nr. 11 ndaj kërkesës së G.G.t, të datës 05.05.2016

²² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 19.05.2016 faqe 14

pse një herë ai i tha atij se ishte në spital, por mua më kujtohet që ai t'i ketë thënë që të takoheshin te restorant Garden afër rrethit.

Atëherë, unë dhe G. shkuam të takoheshim me R. n të cilin G. e pyeti se: "Pse po më shanë mua" kurse R. i tha se: "Nuk të kam sharë ty, por EULEX-in", pastaj ata filluan të diskutonin në lidhje me ngjarjen në të cilën kishte mbetur i plagosur G. kurse G. e pyeti atë nëse; "ai donte që të vinte dhe të betohej në lidhje me rastin e kaluar dhe se për këtë gjë, ai kishte nevojë për 24 pleq, të vinte me ta, të zotohej dhe t'i vihej kapaku kësaj çështje, një herë e përgjithmonë". Por, R. tha se: "ai nuk mund ta bënte këtë sepse ai nuk do të mund t'i mblidhje 24 pleq sepse askush s'do shkonte për të; kurse G. e pyeti atë nëse: "ai ishte në gjendje ta sillte axhën/dajën e tij D. ose B.", nuk më kujtohet emri, por e di që ai kishte folur me R. n në lidhje me axhën/dajën e tij, por edhe për vëllain e R. t po ashtu. R. tha: "vëllai im nuk mund të vij sepse unë ka dy vite që nuk flas me të" dhe si ai i kishte mallkuar (lëçitur), vëllain dhe axhën/dajën e tij tashmë. Atëherë, G. e pyeti atë; "nëse ai vet do të mund të betohej në Kur'an, pas të cilit betim do të rregullohej çështja, një herë e përgjithmonë", kurse R. tha se; "ai nuk do të mund të betohej as në Kur'an e as në Xhami", duke vazhduar me fyerjen e librit të shenjtë dhe të Xhamisë po ashtu. Ai tha se; "ai do të mund të betohej në vëllain e tij i cili qe vrrarë gjatë luftës; unë mund të vij dhe të bëj be në emër të fëmijëve të vëllait të tij sepse vetëm kur bëj be në ta, unë e flas dhe e them të vërtetën, përndryshe, unë nuk do ta flas dhe nuk do ta them të vërtetën nëse betohem në librin e shenjtë apo në Xhami". Atëherë, unë e G. u çuam dhe shkuam në drejtim të veturës kurse N. dhe N. folën me G.n, por unë nuk e di se për çfarë folën ata sepse unë nuk isha aty kurse G. ju tha atyre: "në rregull, ju nuk keni nevojë të bisedoni me të sepse unë tashmë fola me të'. Kështu që, përfundimisht ne hymë në veturë dhe u larguam. Kjo është e tëra dhe asgjë më shumë.

37. Deklarata e M.t vërtetohet me deklaratën e G. t dhe pjesërisht me deklaratën e gazetarit N.SH.t (N.Sh. nuk ka qenë prezent në takimin në mes të R. t dhe G.t). Në

anën tjetër, H.Sh., e [...] e R.Sh.t ka thënë²³ se kur R. është kthyer në shtëpi i ka thënë asaj se ai i kishte treguar G.t “betohem në Kuran apo në çfarëdo që dëshiron”, dhe ata ishin marrë vesh të takoheshin me G.n me datën 14.08.2014. mund të ndodh që R. i kishte treguar asaj për këtë, por nuk ka indikacione tjera për ta konfirmuar këtë. Në të kundërtën, reagimi i G.t me datën 04.08.2014 tregon se R. nuk ka dashur të jep betimin. Kjo po ashtu është konfirmuar me deklaratën e S.M.. Gjykata konstaton se, megjithatë me gjasë se elementet bazike të deklaratës të Mu. janë të sakta.

38. Me datën 04.08.2014 rreth orës 13:00, në Prishtinë, G.G. në mesin e tjerëve është takuar edhe me gazetarin N.SH. n dhe N.M.n, ish zyrtar i policisë në Shërbimin e Inteligjencës të Kosovës. Ata kanë diskutuar për reagimin e R. t në artikujt e Bota Sot, M. dhe Sh. i kishin thënë G.t që të ketë kujdes “sepse këto janë kohëra të rrezikshme për njerëzit të cilët kanë njohuri dhe të ketë kujdes për hir të jetës së tij sepse ai mund të vritet lehtë pasi që shokët e tij janë vvarë”.²⁴ Gjykata nuk ka arsye për të besuar në këtë dhe N.SH. , N.M. dhe G.G. të gjithë e kanë konfirmuar se takimi ka ndodhur.

39. **Dëshmitë e dokumentuara** të paraqitura nga G.G. po ashtu tregojnë se G.G. ka pasur arsye të ketë frikë për jetën e tij dhe ai mbështetet në deklaratat e dëshmitarëve në sfond. Gjykata vuri në dukje se, se për shembull autenticiteti i deklaratës nga UCK-ja, përgjigja dhe SMS-ët nuk janë konfirmuar. Më pastaj, informata në video klipe në intervistat në TV apo në artikuj të gazetave nuk mund të kontrollohen dhe Gjykata nuk ka vënë ndonjë vlerë të veçantë provuese brenda në këtë dëshmi.

40. Gjykata me kujdes ka vlerësuar **dëshmitë e dokumentuara** të paraqitura nga prokurori dhe disa prej tyre janë diskutuar më lartë. Gjykata më tutje ka konstatuar

²³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 01.06.2016 faqe 16 dhe deklarata e H.Sh. për prokurorin _10.11.2014 faqe 3 paragrafi i parë, e cila është lexuar në seancë.

²⁴ E deklaruar nga N.M., procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 17.05.2016 faqe 35

se në veçanti raporti i vendit të ngjarjes, fotot e vendit të ngjarjes, raporti i autopsisë me foto, raporti i ekspertit të balistikës mbështesin konstatimet e Gjykatës. Dokumentet tjera e paraqitura nga prokurori ose nuk janë relevante ose nuk mund t'ju jepet vlerë e veçantë provuese.

41. Në perceptimin e G.G.t në tërësi të kësaj gjendje me jetë-kërcënuese së bashku me paralajmërimin të cilin ai e ka pranuar vetëm disa orë para vrasjes, ka pasur një ndikim të qartë në sjelljen e tij dhe reagimin e përshëndetjes të R. t dhe betimin në ditën e vrasjes. Më pastaj, personaliteti i G.G.t, siç është përshkruar nga eksperti i psikiatrisë, kontribuon për të shpjeguar sjelljen e G.G.t.

Kualifikimi Ligjor

Pika 1

42. G.G. ka privuar nga jeta R.Sh. dhe me këtë ka kryer veprën penale të Vrasjes sipas nenit 178 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-ës).

43. Veprimi i privimit nga jeta të R.Sh.t është vepër penale pasi që G.G. nuk ka vepruar në mbrojtje të nevojshme. Sipas nenit 12 paragrafi (2) të KPK-ës një *“veprimi kryhet në mbrojtje të nevojshme [dhe kjo nuk do ishte vepër penale sipas nenit 12 paragrafi (1)] kur një person kryen veprën për të evituar sulmin e pashmangshëm, të vërtetë dhe të kundërligjshëm kundër tij [...]”* Gjykata nuk konstaton se R.Sh. me të vërtetë ka dashur ta sulmojë në mënyrë të pashmangshme G.G.n. Siç është shtjelluar më lartë nuk është vërtetuar dëshmi objektive se R.Sh. ka pasur revole gjatë të shtënave. Fakti që R.Sh. para të shtënave ka filluar të shtyjë tabelën me dorën e tij të majtë derisa është betuar para G.G.t dhe pastaj në mënyrë të njëhershme ka filluar të ngritët nga karrigia e tij, duke e shtyrë tabelën tutje me dorën e majtë të tij dhe e ka drejtuar në të njëjtën kohë dorën e tij të djathtë drejt rajonit të prehrit të tij në anën e djathtë dhe nuk mund të kualifikohet si e vërtetë dhe si sulm i pashmangshëm. Dhimbja e shpinës të Sh.t dhe vështirësitë për të lëvizur, siç është përshkruar më lartë, shpjegojnë lëvizjet e tij të dorë.

44. Detyrimi i G.G.t për privimin nga jeta R.Sh. nuk përjashtohet nga gabimi i faktit. Sipas nenit 25 paragrafi (1) KPP *“Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale, [...] gabimisht ka menduar se ekzistojnë rrethanat, të cilat faktikisht po të ekzistonin, kjo veprë do të ishte e lejuar. Siç është shtjelluar më lartë, G.G. nuk ka menduar gabimisht se një rrethanë e tillë në lidhje me mbrojtjen e nevojshme ka ekzistuar. Gjykata është e bindur se G.G. e ka racionalizuar veprimin e tij pasi ai e ka pasur mundësinë ti pasqyrojë të shtënat, duke e lënë atë të besojë me prapa vështrim (ish-pozitën) se ai e kishte parë armën.*
45. Veprimi i G.G.t për të privuar nga jeta R.Sh. nuk duhet të kualifikohet si vrasje e rëndë sepse asnjë nga pikat e përmendura nën nenin 179 paragrafi (1) KPP është me vend; dhe as pika 1.5 pasi që G.G. nuk e ka vënë në rrezik jetën e një a më shumë personave derisa ai ka privuar nga jeta R.Sh.. Siç është vërtetuar, G.G. ka shtënë nga distance me pak se një metër në drejtim të R.Sh.t.
46. Në fund, veprimi i G.G.t për të privuar nga jeta R.Sh. nuk është kryer në ankth të rëndë mendor në lidhje me nenin 180 KPP i cili thotë *“Kushdo që personin tjetër e privon nga jeta në gjendje të tronditjes së fortë mendore, të shkaktuar pa fajin e tij nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e personit të vrarë, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet. Edhe pse G.G. në kohën e të shtënave ka qenë në gjendje të tronditjes së fortë mendore, kjo gjendje mendore nuk është shkaktuar nga fyerja e rëndë pa fajin e tij. G.G. i është afruar R.Sh.t duke e pyetur atë nëse R.Sh.: “a i ke mbledhur pleqtë për tu betuar se ku ke qenë me datën 19.10?!”. Kjo pyetje përpara personave të tjerë në tavolinë është konsideruar si provokim nga R.Sh., posaçërisht duke marrë parasysh faktin e shtjelluar më lartë se G.G. ka kërkuar nga R.Sh. vetëm disa ditë më parë të japë betimin për këtë çështje të cilën gjë R.Sh. e kishte refuzuar.*

Pika 2

47. Gjykata ka konstatuar se G.G. ka qenë në posedim të pistoletës në fjalë nga koha e kryerjes të vrasjes derisa është dorëzuar vetë në polici dhe e ka dorëzuar pistoletën. Posedimi i armës ka qenë në shkelje me Ligjin Nr.03/L-143 për Armë sepse nuk ka pasur leje siç është kërkuar me Ligjin e Armëve. G.G. e ka pranuar fajin për këtë Pikë të akuzës dhe Gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë.

Pika 3

48. Gjykata ka konstatuar se vepra penale e Përdorimit të armës apo mjetit të rrezikshëm, neni 375 paragrafi 1, në këtë rast është subsidiar dhe i përdorur nga dënimi aktual i veprës penale të Vrasjes, neni 178, sepse i pandehuri dënohet se ka privuar nga jeta R.Sh. duke përdorur pistoletën.

49. Në parim, një veprim i vetëm mund të përmbajë dy ose më shumë vepra penale, të ashtuquajtura bashkëveprim ideal, nëse veprat penale kanë elemente materiale të dallueshme të ndërsjella. Dikush do të bënte pyetjen nëse veprat kanë elemente të ndryshme; apo nëse dispozitat që krijojnë veprat mbrojnë interesa të ndryshme; apo nëse është e nevojshme për të dënuar të pandehurin për të dy veprat me qëllim që në tërësi të përshkruajë se çfarë ka bërë i akuzuari. Pika fillestare e analizave duhet të jetë një krahasim i elementeve të ndryshme të krimit në mënyrë që të përcaktojë specialitetin reciprok. Për më shumë, elementet kontekstuale duhet të konsiderohen si pjesë e kësaj analize.

50. Për çdo rast, një dënim i mundshëm i dy ose më shumë veprave në bashkëveprim ideal duhet të vlerësohet në pikëpamje të parimit të subsidiaritetit, (lex primaria derogate legi subsidiariae) dhe parimit të përdorimit (lex consumens derogat legi consumptae). Parimi i subsidiaritetit do të zbatohet kur një ndëshkim inferior ose autoritet më i vogël zbatohet kur ndëshkimi bashkëveprues superior nuk është i zbatueshëm. Parimi i përdorimit i referohet marrëdhënieve në mes të veprave e llojit të njëjtë, por me një rëndim shumë të ndryshëm, të cilat janë dizajnuar të mbrojnë të

njëjtën apo interesat e afërta shoqërore, por të cilat ndryshojnë në lidhje me elementet e posaçme.

51. Në abstrakte, përdorimi i armës nuk është një kusht ligjor i nenit 178 I KPK-ës. Më tutje, ndëshkimi i vrasjes kryesisht mbron interesat individuale derisa ndëshkimi i përdorimit të armës pa leje kryesisht mbron interesat publike. Në rastin tonë, sidoqoftë, G.G. është akuzuar dhe është dënuar për Vrasje duke përdor armën si një instrument për të privuar nga jeta personin tjetër. Në këtë gjendje të veçantë, dënimi i Vrasjes do të konsumoj përdorimin e armës pa leje. Më tutje, nëse parimi i konsumimit nuk mund të zbatohet, Gjykata konstaton se parimi i subsidiaritetit atëherë mund të zbatohet në këtë rast të veçantë. Në çdo rast rezultati do të jetë se G.G. mund të dënohet sipas nenit 178, jo sipas nenit 375 paragrafi (1) për përdorimin e armës në Skenderaj me datën 04.08.2014.

52. Duhet të merret parasysh se interesat publike për të pasur leje në lidhje me armën në këtë rast mbulohet me dënimin e Pikës 2, e cila pjesërisht zbatohet në ideal dhe pjesërisht në bashkëveprim real.

53. Më tutje, për njohurinë e kësaj Gjykate, kur vrasja kryhet me përdorimin e armës, ka qenë një praktikë e zakonshme nga gjykatat e Kosovës jo vetëm për të dënuar për Vrasje, jo për përdorimin e armës si shtesë.

54. Vlen të përmendet, nëse neni 178 dhe 375 paragrafi (1) zbatohet në bashkëveprim ideal apo jo, nuk ka ndonjë ndikim substancial për dënimin e grumbulluar, pasi që Gjykata do të konsiderojë përdorimin e armës për të kryer Vrasje si një rrethanë rënduese.

Dënimi

55. Gjykata e konsideron si një rrethanë rënduese sepse vrasja është kryer duke përdor një instrument të rrezikshëm si armë. Vrasja nuk kualifikohet si vrasje e rëndë ashtu

si akuzohet, sidoqoftë, edhe nëse i pandehuri nuk e ka rrezikuar jetën e personit tjetër, Gjykata vendos me peshë si një rrethanë e rëndë, sepse vrasja ka ndodhur në vend publik.

56. Në pajtim me nenin 75 paragrafi 1.3 dhe neni 76 i KPK-ës, Gjykata e ka marrë parasysh, si rrethanë lehtësuese, historia se i pandehuri ka qenë në gjendje të ankthit të rëndë mendor kur ka shtënë në R.Sh.. Vepra penale e neni 180 duhet të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vite. Edhe pse neni 180 i KPK-ës nuk mund të zbatohet siç është vërtetuar më lartë – posaçërisht për shkak se gjendja e tij mendore nuk është shkaktuar nga një fyerje e rëndë pa fajin e tij – janë disa ngjashmëri. *Siç kanë ardhur në përfundim disa ekspertë të psikiatrisë në pikën 4, për të cilën Gjykata pajtohet, i pandehuri ka qenë “në gjendje të tronditjes/afektit të rëndë mendor – të shkaktuar nga frika, akumulim i emocioneve duke ditur drejtimin e ngjarjes, drejtimin e marrëdhënieve të tij me të ndjerin. Në momentin kur e ka parë të ndjerin, në mendjen e tij ka mbizotëruar një afekt/emocion i fortë i frikës, për të ikur apo për të qëlluar, një situatë në të cilën personi ballafaqohet me një gjendje delikate të jetës së tij. Një gjendje të tillë ai nuk ka mundur ta kontrollojë, të frenojë veprimet e tij të cilat kanë rezultuar me kryerjen e veprës penale”.*

57. Sidoqoftë, Gjykata ka vendosur të caktojë një dënim për Vrasjen e kryer nën minimumin prej pesë vitesh siç është përcaktuar me nenin 178.

58. Në pajtim me dispozitat e neni 374 paragrafi (1), 45, 75 paragrafi (1.3) dhe 76 i KPK-ës, G.G. dënohet me 10 – dhjetë – muaj burgim për veprën e përmendur nën pikën 2. Gjykata ka marrë parasysh si rrethanë lehtësuese se G. e ka dorëzuar pistoletën e tij në polici dhe e ka pranuar fajin.

59. Në pajtim me nenin 80 paragrafi (2.2) I KPK-ës, Gjykata ka caktuar një dënim të GRUMBULLUAR prej 4 – katër – vite e 6 - gjashtë – muaj burgim.

60. Koha e kaluar në paraburgim nga data 22.08.2014 deri me datën 21.11.2014 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 21.11.2014 derisa ai është liruar me vendim të Gjykatës me datën 03.06.2016 – 1 vit e 9 muaj dhe 12 ditë – është përfshirë në dënim me burgim në pajtim me nenin 365 paragrafi (1), nën-paragrafi (1.5) të KPP.

Konfiskimi

61. G.G. nën pikën 2 është dënuar për posedim të kundërligjshëm të armëve, dhe pistoleta e kalibrit 7.62 mm, M-57, gjysmë-automatike, me numër serik [...], i prodhimit Jugosllav, është konfiskuar në pajtim me KPK-ës neni 374 paragrafi (3).

Shpenzimet e procedurës

62. G.G. është dënuar për veprën penale të Vrasjes (ri-kualifikim i veprës Vrasje e Rëndë) dhe posedim të kundërligjshëm të armës. Gjykata refuzon akuzën nën Pikën 3. Gjykata konstaton, sipas parimit të KPP nenit 453 paragrafi (2), se G.G. duhet të kompensojë vetëm një pjesë të shpenzimeve, në këtë rast 1000 Euro. Gjykata më tutje konstaton se caktimi i plotë i pagesës do të rrezikonte mbështetjen e gruas së të pandehurit dhe fëmijëve, duke marrë parasysh familjen e tij dhe gjendjen ekonomike.

Kërkesa pasurore juridike

63. Në pajtim me nenin 463 të KPP, udhëzohet Pala e Dëmtuar H.Sh. se ajo mund të ndjek kërkesën e saj pasurore juridike në çështje gjyqësore civile.

Aktgjykimi me arsyetim është lëshuar me datën 14 qershor 2016.

Vidar Stensland

Procesmbajtës

Agron Kelmendi

KËSHILLË LIGJORE: I pandehuri , avokati i tyre ligjor , prokurori apo Pala e Dëmtuar mund të parashtrojnë ankesë kundër këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 380 paragrafi (1) dhe 381 paragrafi (1) i KPP brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh prej ditës së dorëzimit të këtij aktgjykimi. Çdo ankesë duhet të parashtrohet në Gjykatë të shkallës së parë sipas nenit 388 paragrafi (1) i KPP.